



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 1647 Prot.

Tiranë, më 27.09.2017

**V E N D I M**

Nr.200, datë 27/09/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 7, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 7, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan", në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan,

**VËREJ SE:**

Me Vendimin Nr. 139, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 7, datë 31.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.



4. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

*Institucioni i mbikëqyrur, t'i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*

*Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*

*Një kopje e përshkrimeve të punës, të nënshkruara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.*

*Komunikimet në mënyrë elektronike duhet të materializohen në një kopje në letër, si dhe duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”. Në bazë e për zbatim të këtij të fundit, ka dalë dhe Udhëzimi nr. 1, datë 31.12.2012, i Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, “Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike”, i cili në përmbajtjen e tij udhëzon Institucionet Publike për mënyrën dhe elementet që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik. Kjo kopje duhet të trajtohet në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

5. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil.

*Për rregullimin e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:*

- *Të anulojë aktin nr. 3272/17 prot., datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” për punonjësen \*\*\*\*\*, me të cilin është deklaruar “Nëpunës civil”;*
- *Të anulojë aktin nr. 3272/24 prot., datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me të cilin është deklaruar “Nëpunës civil”;*
- *Të anulojë aktin nr. 3272/34 prot., datë 05.02.2015, , “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është deklaruar “Nëpunës civil”;*
- *Të anulojë aktin nr. 3272/22 prot., datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me të cilin është deklaruar “Nëpunës civil”;*

**6.** *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore, për masën e marrë ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, duke u kujdesur që, në zbatim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit për dhënie mase disiplinore “vërejtje”, ndaj nëpunëses në fjalë, për shkak të mosrespektimit të procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore si dhe rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.*

*Për rregullimin e situatës, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan duhet të veprojë si më poshtë:*

- *Të anulojë aktin administrativ nr. 38 prot., datë 10.06.2016, “Dhënie e masës disiplinore vërejtje”, të Prefektit të Qarkut Elbasan, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, si akt absolutisht i pavlefshëm.*
  - *Të fshijë masën disiplinore për nëpunësen \*\*\*\*\*, nga dosja personale dhe regjistri përkatës, i cili administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.*
- 7.** *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit të sistemojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato që janë konstatuar me mangësi në anekset përkatëse, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30 ditë** nga marrja dijeni për këtë vendim. Subjekti i mbikëqyrur, Prefekti i Qarkut Elbasan dhe njësia përgjegjëse (DAP) duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 7, datë 31.01.2017, të Komisionerit, me Vendimin Nr. 141, datë 30.06.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 7, datë 31.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 12.07.2017, u paraqitën pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1334/2 prot., datë 30.06.2017 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personat e kontaktit të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, në pozicionin “Përgjegjësi i Sektorit Juridik”.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Me shkresën nr. 1314/4 prot., datë 18.02.2017, “Kërkojmë opinionin tuaj ligjor”, Prefekti i Qarkut Elbasan, në zbatim të pikës 2 të rekomandimit të vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike interpretim në lidhje me kategorinë dhe klasifikimin e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në skemën e administrimit të shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur ende në lidhje me kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, sikundër ishte lënë detyrë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionerit.

- Në zbatim të pikës 3 të vendimit dhe orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka drejtuar procesin për rregullimin e procedurave të kërkuara nga ligji për konfirmimin e nëpunësve civil në përfundim të periudhës së provës. Konkretisht:

- Me Vendimin Nr. 38/1, datë 28.02.2017, “Mbi anulimin e vendimit të prefektit Nr. 1, datë 14.07.2015 dhe Vendimin Nr. 12, datë 29.01.2016”, njësia e burimeve njerëzore e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan ka anuluar aktin administrativ kolektiv Nr. 1, datë 14.07.2015, për konfirmimin e nëpunësve civil, (\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*) dhe aktin Nr. 12, datë 29.01.2016, me të cilin rikonfirmohej si nëpunës civil punonjësi \*\*\*\*\*, si akte absolutisht të pavlefshme.
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka përfunduar procesin e vlerësimeve të rezultateve individuale në punë për nëpunësit civilë në periudhë prove, sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” (kopje të vlerësimeve janë administruar nga grupi i punës dhe janë bërë pjesë e dosjes së verifikimit).
- Pas përfundimit të trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s dhe dhënies së mendimeve me shkrim për nëpunësit civilë në periudhë prove, nga nëpunësit më të vjetër në detyrë, sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimet në kategorinë ekzekutive”, janë nxjerrë aktet individuale të konfirmimit nga eprori direkt, konform pikës 3 dhe 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht:
  - Me aktin nr. 907 prot., datë 30.10.2015, nëpunësja \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”.
  - Me aktin nr. 908 prot., datë 30.10.2015, nëpunësi \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kompetencave Vendore”.
  - Me aktin nr. 909 prot., datë 30.10.2015, nëpunësi \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialist i Shërbimeve në Nënprefekturën Librazhd”.
  - Me aktin nr. 910 prot., datë 30.10.2015, nëpunësja \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialiste e Territorit, Turizmit dhe Funksioneve të Deleguara”.
  - Me aktin nr. 911 prot., datë 30.10.2015, nëpunësi \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialist i Emergjencave Civile në Nënprefekturën Gramsh”.
  - Me aktin nr. 912 prot., datë 30.10.2015, nëpunësja \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Financës”.
  - Me aktin nr. 913 prot., datë 30.10.2015, nëpunësja \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialiste për Marrëdhënien me Publikun dhe Protokoll-Arkivi”.
  - Me aktin nr. 37 prot., datë 19.01.2016, nëpunësi \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialist i Emergjencave Civile dhe Shërbimesh, në Nënprefekturën Peqin”.
  - Me aktin nr. 403 prot., datë 18.03.2016, nëpunësi \*\*\*\*\* është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”.

Pavarësisht se këto akte datojnë përpara daljes së vendimit të Komisionerit, në momentin e mbikëqyrjes ato nuk i janë vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes.

- Në zbatim të pikës 4 të vendimit paralajmërues u konstatua se njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka hartuar përshkrimet e punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil. Më tej, me shkresën nr. 1314/4 prot., datë 18.02.2017, "*Kërkojmë opinionin tuaj ligjor*", i ka kërkuar njësisë përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin me shkrim lidhur me përshkrimet e punës nëse janë hartuar në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar në lidhje me përshkrimet e vendeve të punës. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar. Për këtë arsye, përshkrimet e punës nuk i janë dërguar ende për nënshkrim nëpunësit të ngarkuar me këtë detyrë (*Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme*).
- Në pikën 5 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, i është kërkuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, që në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.

Ashtu sikundër është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur në subjekt gjatë procesit të verifikimit, rezulton se Departamenti i Administratës Publike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e kësaj pike të vendimit të Komisionerit.

- Për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në rastin e dhënies së masës disiplinore "*vërejtje*", ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, në zbatim të pikës 6 të dispozitivit të Vendimit të Komisionerit, me aktin nr. 1314/6 prot., datë 28.02.2017, "*Mbi anulimin e vendimit të Prefektit nr. 38 datë 10.06.2016*", ka anuluar aktin administrativ nr. 38 prot., datë 10.06.2016, "*Dhënie e masës disiplinore vërejtje*", ndaj kësaj nëpunëseje, si akt absolutisht i pavlefshëm. Fshirja e masës nga regjistri përkatës, i cili administrohet nga Departamenti i Administratës Publike nuk është bërë për shkak se masa nuk ishte reflektuar në regjistër. Nga ana tjetër, njësia e burimeve njerëzore e ka hequr masën disiplinore për këtë punonjëse nga dosja personale.
- Në zbatim të pikës 7 të vendimit të Komisionerit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka sistemuar dosjet e personelit të çdo nëpunësi civil në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit Nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*". Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se ishin të përfshira dokumente me të dhënat personale të

karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 7, datë 31.01.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan”*, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar. Aktualisht, pritet reagimi i Departamentit të Administratës Publike në lidhje me:

1. Kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni *“Sekretar i Përgjithshëm”*, në institucionin e prefektit të qarkut ose pozicionin e barasvlershëm me të, detyrë e lënë në pikën 2 të vendimit të Komisionerit.
2. Konfirmimin nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, përcaktuar në pikën 4 të vendimit.
3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin, siç është përcaktuar në pikën 5 të vendimit.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 7, datë 31.01.2017 në institucionin e Prefekturës të Qarkut Elbasan.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 7, datë 31.01.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan”*.
3. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 4 dhe 5 të dispozitivit të Nr. 7, datë 31.01.2017, për të cilat kërkohet reagimi i Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe të informohet Komisioni për



Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**